

PICASSO PROFI - 15



PËRSHKRIMI

Bojë plastike e një cilësie të lartë me veti shumë të mira mbuluese dhe niveluese.

KARAKTERISTIKAT E PRODUKTIT

- Sipërfaqe të lëmuar mat
- Gjendet në 3 baza W, P dhe D
- Ngjitje shumë e fortë dhe tharje e shpejtë
- Mbulueshmëri dhe bardhësi shumë e mirë
- Rezistencë e mirë ndaj larjes së shpeshtë
- Ngjyra të qëndrueshme për një kohë të gjatë
- Pranon 3000 cikle larjesh 30 ditë pas aplikimit.
- Vetë shumë të mira punueshmërie dhe niveluese

PËRDORIME TË REKOMANDUARA

Përdoret në të gjithë muret dhe tavanët e brendshëm, të rinj, të vjetër dhe të lyer më parë me bojë, me bazë çimento, gëlqere, gips, dhe në çdo lloj ambienti të brendshëm, dhoma gjumi, tualete, dhoma ndenjjeje, ambiente zyrrash, shërbimesh etj.

KARAKTERISTIKA TEKNIKE

Rezina	PVA VEOVA Polimer
Densiteti EN ISO 2811-1	1,55±0,02 gr/ml
Mbetja e thatë EN ISO 3251	65%
Shkalla e hollimit	10 – 15%
Viskoziteti	110 ± 5 KU
Koha e tharjes mes dy shtresave	2 - 4 orë
VOC në produktin e gatshëm (Di rektiva Europiane 2004/42/EC) (g/l)	≤ 10
VOC emetimi në ambient, dhomë simulimi ISO 16000 (mg/m3)	≤ 0.2
Aftësia mbuluese EN ISO 6504-3	≥ 98% Klasa II
Rezistenca ndaj larjes ISO 11998	Klasa II

UDHËZIME APLIKIMI

- Metoda e aplikimit: Furçë, rrul ose me sprucim.
- Hollimi: Rekomandohet të hollohet me 10 - 15% ujë, përveç bazës D që nuk sugjerohet më shumë se 5%.

PËRGATITJA E SIPËRFAQES

Sipërfaqet duhet të jenë të thara plotësisht, të pastra dhe pa elemente që pengojnë ngjitshmërinë e bojës. Riparoni të gjitha plasaritjet dhe pjesët e dëmtuara duke përdorur produktet e linjës Deutschcolor, Natur Kalk, Vox 707, Glatte Spachtel, Spachtel Finish, etj. Më pas rekomandohet të aplikohet astar Macht Tiefgrund Wasser, i holluar me ujë në raportin 1:1 ose astar Macht Haftgrund i holluar me ujë në raportin 1:3. Gjatë aplikimit të astarit evitoni krijimin e një cipe e cila më pas krijon probleme në lidhjen e bojës me suportin.

PAKETIMI

1 lt, 3 lt, 10 lt, 15 lt

RUAJTJA

36 muaj nëse ruhet në një vend të thatë, larg burimeve të nxehtësisë, në një temperaturë midis +5°C dhe +30°C. Mbrojeni nga ngrica.

INFORMACIONI MBI SHËNDETIN, SIGURINË DHE MJEDISIN

Mbajeni larg fëmijëve produktin. Nëqoftëse gjelltitet lajmëroni dhe kërkoni ndihmën e mjekut dhe tregojini atij përmbajtjen e ambalazhit. Mos e hidhni produktin në tubacione ose kanale.

SHËNIME

- Rekomandohet që sipërfaqet e lyera të mos lahen deri sa të kalojnë 30 ditë nga aplikimi.
- Në sipërfaqet e freskëta të betonit produkti rekomandohet të aplikohet të paktën pas 30-40 ditësh.

